

Mënyra për përmirësimin e shëndetit të thundrave

*Përmbledhur nga Ing. Franz Riegler, konsulent i Schaumann
dhe aksioner i Austria Praemix shpk.*



Çdo një në dhjetë lopë largohen nga stalla për shkak të thundrave dhe sëmundjeve të tyre; kjo është vetëm maja e ajsbergut. Sondazhet tregojnë se përqindja e lopëve të çala në tufë është ndërmjet 6% dhe 40%, dhe nuk janë të rralla fermat të cilat kanë një përqindje më të lartë.

Mesatarisht në tridhjetë përqind (30%) të kafshëve janë gjetur defekte në çastin e prerjes së thundrës. Megjithatë shkalla aktuale dhe pasojat e këtij problemi shpesh nënvlerësohen pasi humbjet direkte, domethënë kostot e trajtimit, paraqesin vetëm një aspekt. Me rëndësi janë humbjet indirekte, shkaktuar nga humbja e peshës dhe pasojat e kësaj të fundit tek prodhimtaria e qumështit dhe pjelloria.

Në varësi të gradës së problemit prodhimtaria e qumështit në këto kushte pëson një ulje prej më shumë se 400 litra për laktacion. Sipas përlllogaritjeve të veterinerëve amerikanë, ulja e prodhimtarisë së qumështit shumëzohet me faktorin 2.5 për të arritur në humbjen e

përgjithshme të prodhimit të së qumështit. Veçanërisht shqetësues është fakti se rastet me thundra të dëmtuara gjenden zakonisht te kafshët me prodhimtari të lartë qumështi.

Lajmi i mirë:

Ekziston ndihmë për çdo problem të thundrave. Parakusht është fillimi i menjëhershëm dhe implementimi i qëndrueshëm i një plani prej pesë pikash për të marrë nën kontroll problemet e thundrave në një tufë lopësh qumështi.

5 Hapa për thundra të shëndetshme:

1. Identifikimi i problemit
2. Përkujdesje funksionale për thundrat
3. Mirëmbajtje dhe higjenë
4. Optimizim i të ushqyerit
5. Përdorimi i qëllimshëm i premikseve



Para përkujdesjes së thundrave (majtas) – pas përkujdesjes së thundrave (djathtas). Një prerje e saktë e thundrave siguron kushte optimale të ngarkesës së peshës mbi thundër.

1. Identifikimi i problemit të thundrave në tufë

Ky, dhe pse mund të duket befasues, është një problem gjithnjë e më i përhapur. Dukuria e kalimit dhe përhapja në tufë shpesh nuk njihet në masën e duhur. Identifikimi dhe vlerësimi i shkallës së rëndësisë së problemit janë natyrisht kusht për të gjitha hapat e mëtejshme të përmirësimit të shëndetit të thundrave.

2. Përkujdesja e thundrave

Një thundër e formuar në mënyrë natyrale, e prerë sipas aspekteve funksionale është kusht themelor për shëndetin e thundrës. Vetëm një thundër e kujdesur sipas standarteve funksionon në mënyrë të përsosur biomekanikisht, që do të thotë, të gjitha zonat e thundrës ngarkohen fiziologjikisht në mënyrë optimale dhe të ngjeshura në mënyrë lokale dhe dëmtimi i qarkullimit të gjakut dhe i indeve mund të shmanget në masë të madhe. Nuk është e këshillueshme, për shembull, t'i ushqesh me biotin ose zink, për sa kohë thundra nuk është trajtuar siç duhet.

3. Mirëmbajtja dhe higjena

Viçi, për shkak të zhvillimit të tij natyror, nuk është i mundur të qëndrojë dhe të ecë për një periudhë të gjatë nëpër terrene të vështira. Në praktikë, është e përcaktuar qartë se faktorët mekanikë ndikojnë në pothuajse të gjitha sëmundjet e thundrave. Toka ka ndikim në formën e thundrës, si dhe në biomekanikë. Kjo shpjegon rëndësinë e tokës në patogjenezën e sëmundjeve të thundrave. Sistemet e mirëmbajtjes me sipërfaqe të buta dhe të njoma mund të reduktojnë sëmundjet e thundrave dhe në këtë mënyrë rrisin mirëqënien e kafshës.

Rëndësia e higjenës së dyshemesë së stallës është përgjithësisht e njohur. Megjithatë, shpesh lihet pas dore. Thundrat, të cilat janë vazhdimisht në ujë dhe pluhur, janë më të predispozuar për t'u sëmurur. Edhe shollët e thundrës më rezistente herët ose vonë do të dëmtohen në kushte të tilla.

4. Ushqyerja

Përsa i përket të ushqyerit, është e rëndësishme përgatitja e racionit sipas nevojave bazë dhe ripërtypëse. Krahas kësaj, te kafshët me performancë të lartë kemi një përkujdesje të veçantë me vitamina, minerale dhe mikroelemente të ndryshme.

5. Përdorim i qëllimshëm i premikseve

Me këtë nënkuptohen shtesat me biotin dhe/ose zink mbi normën si një masë e përhershme. Nëse efekti i dëshiruar arrihet pas rreth dy deri në katër muaj, ky premiks është thelbësor të vazhdohet dhe më tej. Nëse tek premiksi mungon ose vonon ndikimi pozitiv me kalimin e kohës mund të ndodhë që problemet të rikthehen.

Zbatimi i vazhdueshëm i pikave një deri në katër e bën të panevojshme pikën pestë.

Ndikimi i shumë faktorëve

Se cilët faktorë duhen ndryshuar, kjo varion nga një fermë në tjetrën. Tërësia e faktorëve të ushqyerjes, metabolizmit, stallës, gjenetikës, terrenit dhe higjenës ndikojnë në shëndetin e thundrës. Përveç kësaj, faktorët individualë janë të lidhur me nivelin e performancës së tufës. Nëpërmjet parandalimit, dhimbjet dhe stresi, nga dëmtimet e thundrave, mund të reduktohen ndjeshëm.

Përkujdesja e thundrave është punë dedektive

Në fund të fundit, çalimet janë të menaxhueshme – pak rëndësi ka nëse shkak është, për shembull, sëmundja e laminitis. Një raport paraprak dhe prerje ortopedike korrekte dhe e dokumentuar e thundrave janë mjete të rëndësishme në luftën kundër sëmundjeve të thundrave. Ashtu si një tahograf i jep ekspertit të dhëna të rëndësishme, shumë informacion mund të merret nga gjendja e thundrës. Çelsi i suksesit gjendet në vlerësimin e këtyre diagnozave. Ato mundësojnë korrigjimin e saktë dhe optimizimin e faktorëve përkatës. Me këtë informacion zhvillohet një plan specifik për përkujdesjen e kafshës.

Së fundmi, vetëm një prerje e saktë e thundrës mund të japë përfundime optimale. Përkujdesja për thundrat është një punë që kërkon kujdes të vazhdueshëm, e cila ia vlen. Potenciali i performancës së lopëve të qumështit do të vihet plotësisht në përdorim. Në përgjithësi, kjo çon në më shumë efikasitet tek kafshët e qumështit.